



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave dhe Transfereve

Ministarstvo Finansija i Transfera - Ministry of Finance and Transfers

Departamenti për Politika Makroekonomike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar

Buletini Ekonomik Tremujor Tetor- Dhjetor, 2019

Buletini Ekonomik Tremujor ofron një përditësim të disa prej zhvillimeve kyçe brenda disa sektorëve të ekonomisë. Buletini gjithashtu përshkruan zhvillimet fiskale për shtetin si dhe parashikimet më të azhurnuara të Departamentit. Buletini është dizajnuar me qëllim që të jetë edhe informativ dhe i arritshëm për të gjithë lexuesit. Buletini mund të përdoret për punime kërkimore ose për qëllime prezantimi, vetëm me citimin e burimit.

Përmbajtja

ZHVILLIMET E EKONOMISË SË JASHTME	3
SEKTORI REAL	5
Rritja Ekonomike	5
SEKTORI I JASHTËM	8
Llogaria Rrjedhëse	8
Llogaria Financiare	9
SEKTORI FINANCIAR	10
TREGU I PUNËS	10
KLIMA E BIZNESIT	11
Regjistri i bizneseve, TM4 2019	11
Anketa e Odës Ekonomike të Kosovës TM4 2019	11
Financat Publike	12
Të hyrat	12
Shpenzimet	12
Bilanci i përgjithshëm buxhetor	13
INFORMATA TË TJERA: ANALIZË E LLOGARISË RRJEDHËSE NGA KËNDVËSHTRIMI I HENDEKUT NDËRMJET KURSIMEVE DHE INVESTIMEVE	14

ZHVILLIMET E EKONOMISË SË JASHTME

Tremujori i katërt i 2019 u karakterizua nga një stabilizim në sektorin e prodhimit si rezultat i politikave monetare dhe fiskale të ndërmarra gjatë fillimit të vitit nga disa shtete si: Kina, Korea dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Rënia e ndjesisë së bizneseve ka ndaluar gjatë këtij tremujori (trend i njëjtë si me performancën e sektorit të prodhimit), por megjithatë ndjesia e përgjithshme është pesimiste. Ndërsa, sektori i shërbimeve edhe pse ka pësuar një rënie të lehtë, ende vazhdon të jetë i qëndrueshëm (si rezultat i konsumit të qëndrueshëm).

Sa i përket shifrave të këtij tremujori, rritja reale globale ishte 2.9% (njëjtë si ajo e gjithë vitit). Ndërsa në ekonomitë e zhvilluara rritja ishte 1.5% gjatë tremujorit të katërt (0.2 p.p. më e ulët se ajo e tërë vitit në këto ekonomi, pra 1.7%). Ndryshe nga ekonomitë e zhvilluara, ato në zhvillim patën rritje prej 4.0% (0.3 p.p. më lart se rritja e tërë vitit – 3.7%). Sa i përket shifrave vjetore të rritjes reale, si rezultat i vazhdueshmërisë së problemeve në sektorin e prodhimit, përsëri ka pasur një rishikim për poshtë (bazuar në publikimet e fundit). Rritja globale për 2019 parashihet të jetë 2.9%; 3.3% për 2020; dhe 3.4% për 2021. Vitet 2019 dhe 2020 janë rishikuar për poshtë me 0.1 p.p., ndërsa 2021 është rishikuar për poshtë me 0.2 p.p..

Rritja në **eurozonë** gjatë tremujorit të katërt nuk ishte në një nivel të kënaqshëm përkundër sezonalitetit të favorshëm kryesisht për shkak të ndikimit negativ global nga sektori i prodhimit. Krahasuar me TM3, BPV-ja e përshtatur sezonalisht në eurozonë dhe BE28 gjatë TM4 u rrit për 0.1 p.p., përkatësisht. Po ashtu, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, BPV-ja e përshtatur sezonalisht u rrit me 1.0% dhe 1.1% në eurozonë dhe BE28, përkatësisht¹. Rritja reale gjatë 2019 ishte 1.2%, ndërsa gjatë 2020 është parashikuar 0.8% (rishikim për poshtë prej 0.3 p.p. krahasuar me parashikimet e dhjetorit 2019), dhe gjatë 2021 rritja parashihet të jetë 1.3% (rishikim për poshtë prej 0.1 p.p.).

Arsyeja prapa rishikimeve për poshtë për vitin 2020 është paraqitja e virusit COVID-19 (koronavirusi). Për momentin, është evident rënia e prodhimit në Kinë – 13.5% më pak gjatë janar-shkurt 2020 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, dhe 20.5% shitje me pakicë më pak duke krahasuar të njëjtat periudha.² Po ashtu, disa indekse të aksioneve sikurse FTSE 100, Dow apo S&P 500 kanë pësuar rënien më të madhe prej vitit 1987 gjatë pjesës së parë të marsit 2020.³ Rrjedhimisht, të gjitha projeksionet e lartpërmendura mund të ndryshojnë. Këtë pohim e mbështet edhe OECD duke vlerësuar se si rezultat i virusit COVID-19 rritja globale e parashikuar për 2020 mund të përgjysmohet.⁴

Inflacioni në eurozonë ishte 1.3% në dhjetor të vitit 2019 (0.5 pikë të përqindjes më e ulët se në qershor), me kontribut më të madh të ardhur nga komponenti i shërbimeve (+0.80 p.p.), pasuar nga ushqimi, pijet alkoolike dhe duhani (+0.38 p.p.), produktet industriale (duke përjashtuar

¹ Eurostat janar 2020

² China Retail Sales, Industrial Production Plunge: <https://www.bloomberg.com/news/videos/2020-03-16/china-retail-sales-industrial-production-plunge-video>

³ Coronavirus: FTSE 100, Dow, S&P 500 in worst day since 1987: <https://www.bbc.com/news/business-51829852>

⁴ Coronavirus: The world economy at risk: <http://www.oecd.org/berlin/publikationen/Interim-Economic-Assessment-2-March-2020.pdf>

energjinë) (+0.12 p.p.), dhe energjia (+0.02 p.p.)⁵. Normat më të ulëta të inflacionit u regjistruan në Qipro (0.7%), Portugali (0.4%), dhe Itali (0.5%). Në anën tjetër, normat më të larta të inflacionit u regjistruan në Hungari (4.1%), Rumani (4.0%), dhe Çeki dhe Sllovaki (të dyjat 3.2%)⁶.

Tabela 1. Indikatorët kryesorë të ekonomisë botërore

v-m-v, %, nëse nuk ceket ndryshe	2018	2019	2020
BPV Botërore ^(FMN WEO janar 2020)	3.6	2.9	3.3
Inflacioni, çmimet mesatare të konsumit (në ekonomitë e zhvilluara) ^(FMN WEO janar 2020)	2.0	1.4	1.7
Inflacioni, çmimet mesatare të konsumit (në ekonomitë në zhvillim) ^(FMN WEO janar 2020)	4.8	5.1	4.6
BPV në Euro Zonë ^(BQE Parashikimet mars 2020)	1.8	1.2	0.8
Inflacioni në Euro Zonë ^(BQE Parashikimet mars 2020)	1.8	1.2	1.1

Në krahasim me tremujorin e tretë, çmimet e mallrave bazë gjatë tremujorit të katërt në përgjithësi kanë pësuar rritje (duke përfshirë çmimet e ushqimit, produkteve bujqësore, dhe metaleve ndër tjera). Ndryshe prej trendit të ngritjes së çmimeve të mallrave bazë në përgjithësi (dhe atyre të ushqimit dhe pijeve dhe naftës), çmimi i nikelit ka rënë nga 15,651 dollarë mesatarisht gjatë TM3 në 15,349 në TM4. Çmimi i nikelit ka rëndësi të madhe për ekonominë tonë duke pasur parasysh faktin që më shumë se 35% të eksporteve të Kosovës janë brenda kategorisë ekonomike të ‘Metaleve bazë dhe artikujve prej tyre’; kategori e cila dominohet nga eksporti i nikelit. Vlen të ceket fakti që nikeli është përbërës i rëndësishëm në industrinë e veturave elektrike, industri me ngritje të hovshme (sidomos gjatë vitit të fundit).

Tabela 2. Çmimet e mallrave bazë

	2017	2018				2019			
	Mes.	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4
Indeksi i çmimeve të të gjitha mallrave bazë ^(FMN çmimet e komoditeteve)	113.6	127.8	131.4	130.5	124.0	118.9	120.2	115.4	116.6
Indeksi i çmimeve të ushqimit dhe pijeve ^(FMN çmimet e komoditeteve)	103.2	105.4	106.0	98.7	98.2	98.9	99.8	97.9	99.1
Çmimi i naftës bruto, Brent ^(BB Pink Sheet)	54.4	67	74.5	75.5	67.4	63.3	68.3	61.9	62.7
Nikel, \$ për ton metrik ^(BB Pink Sheet)	10,159	13,284	14,470	13,239	11,463	12,412	12,244	15,651	15,349

⁵ Eurostat janar 2019

⁶ Ibid.

SEKTORI REAL

Rritja Ekonomike


Ecuria Makroekonomike 2019

Në mungesë të të dhënave zyrtare nga ASK-ja për BPV në tremujorin e katërt të 2019-ës, në këtë Buletin analizohen të dhënat më të fundit të disponueshme, që i përkasin tremujorit të tretë të 2019-ës dhe më tej ofrohet një vlerësim cilësor për pritjet e aktivitetit ekonomik për tremujorin e katërt.


Në tremujorin e tretë të vitit 2019, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), ekonomia e Kosovës u rrit me 4.4% (v-m-v) në terma realë dhe me 5.2% (v-m-v) në terma nominalë.

Norma reale e rritjes në tremujorin e tretë të 2019-ës kryesisht i atribuohet konsumit privat dhe qeveritar (me kontribut 1.7 p.p dhe 1.2 p.p, respektivisht) dhe investimit total (1.03 p.p). Kontributi i eksporteve neto rezultoi pozitiv (0.4 p.p), si rezultat i kontributit në rritje i eksporteve totale (4.2 p.p), i cili është kompensuar pjesërisht nga kontributi negativ i importeve (rreth -3.8 p.p).

Grafiku 1 Kontributet në BPV



Grafiku 2 BPV reale sipas aktiviteteve, v-m-v, %



Në tremujorin e tretë të 2019-ës, bazuar në ndarjen e BPV-së sipas aktiviteteve ekonomike, sektori i “shërbimeve”⁷ vazhdon të ketë kontributin më të lartë në rritjen reale të BPV-së (rreth 2.0 p.p.), për t’u ndjekur nga sektori i “industrisë” (rreth 1.0 p.p) dhe nga sektori i “ndërtimtarisë” (rreth 0.3

⁷ Sektori i shërbimeve përfshin kategoritë: “tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave”, “transporti dhe magazinimi”; “hotelet dhe restorantet”; “informimi dhe komunikimi”, “aktivitetet financiare dhe te sigurimit”; “afarizmi me pasuri të patundshme”, “administrimi publik” dhe “shërbime të tjera”.

p.p).⁸ Ndërkohë, sektori i “ Bujqësisë, Pylltarisë dhe Peshkimit” ka shfaqur një kontribut negativ me rreth -0.2 p.p.

Gjatë periudhës janar- shtator të vitit 2019, rritja ekonomike reale luhetet rreth vlerës 4.3%, ndërsa ajo nominale rreth vlerës 5.6%.

Pritjet për ecurinë makroekonomike për TM4 2019

Në mungesë të të dhënave zyrtare nga ASK-ja për BPV-në në tremujorin e katërt të 2019-ës, indikatorët indirekt të kërkesës agregate japin sinjale për rritje më të ngadaltë ekonomike se në tremujorin paraardhës (2019TM3).

- Sinjalet për ecurinë e konsumit privat gjatë 2019T4 janë të përziera. Nga njëra anë, rritja më e lartë e importeve të mallrave të konsumit (10.2%, *v-m-v*) dhe rritja më e madhe e mbledhjes së TVSH-së (8.2%, *v-m-v*) sugjerojnë përshpejtim të konsumit privat. Ndërsa, nga ana tjetër, rritja më e ngadaltë e kompensimit të punëtorëve (të ardhurat primare) dhe remitencave dhe rënia e kredisë së re për qëllime të konsumit mbështesin një tendencë ngadalësuese të konsumit privat në 2019T4.
- Konsumi publik⁹ është rritur me rreth 10.0% në tremujorin e katërt të 2019-ës (*v-m-v*). Kjo normë është më e ulët se norma e rritjes në tremujorin paraardhës.
- Sinjalet për investimet private sugjerojnë një ngadalësim të rritjes në 2019TM4, si rezultat i:
i) ngadalësimit të kredisë së re për qëllime investimi me 6.3%; *ii*) rënies së investimeve të huaja direkte me rreth 43.8%; dhe *iii*) pasigurisë së krijuar si rezultat i zhvillimeve politike në vend.
- Dinamika e investimeve publike në tremujorin e katërt të 2019-ës, ashtu siç pritej, është përshpejtuar ndjeshëm në terma vjetorë (16.6%) dhe në tremujorë (128.8%).
- Deficiti tregtar i mallrave dhe shërbimeve në tremujorin e katërt të 2019-ës është rritur me rreth 11.2 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Inflacioni

Në TM4 2019, Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) u rrit me rreth 1.7% në terma vjetorë. Kjo normë është më e ulët se norma e inflacionit e regjistruar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (rreth 2.1%). Dinamika mujore e ecurisë të inflacionit shfaq shenja ngadalësimi, duke shënuar një normë vjetore prej 2.1%, 1.7% dhe 1.1% në muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2019, respektivisht.

Nënkategoritë e IÇK-së që treguan rritjen më të lartë ishin:

- Kategoria e ushqimit me një rritje vjetore prej 3.3% dhe një kontribut në inflacionin total prej 1.1 p.p. (kryesisht si rezultat i rritjes së çmimit të "bukës dhe drithërave" dhe "mishit").


⁸ Sektori i industrisë përfshin kategoritë: “industria nxjerrëse”, “industria përpunuese”, “furnizimi me energji elektrike dhe gaz”, dhe “furnizimi me ujë”.

⁹ Konsumi Publik përfshin dy kategori të shpenzimeve: “paga dhe mëditje” dhe “mallra dhe shërbime” dhe “shpenzime publike”.

- Kategoria e pijeve joalkoolike (me një rritje vjetore prej 3.3% dhe kontribut prej 0.19 p.p);
- Kategoria e pijeve alkoolike dhe duhanit pati një kontribut më të ulët se në tremujorin paraardhës, me rreth 0.11 p.p.
- Kategoria “Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” ndryshoi kahun e tendencës rritëse në 2019T4, duke shënuar një normë vjetore rritje më të ngadaltë se në tremujorin paraardhës, me rreth 1.9% ose një kontribut prej 0.16 p.p.
- Ndërkohë, çmimi i kategorisë së “transportit” vazhdoi tendencën rënëse të nisur në 2019TM3, duke shënuar një rritje negative, mesatarisht prej -0.3 %.


Tabela 3 Kontributet e kategorive kryesore në inflacionin vjetor

Nën kategoritë kryesore të IÇK	2017	2018				2019			
	mes.	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4
Ushqimi dhe pijet jo-alkoolike	0.60	0.24	0.25	0.87	1.12	2.54	2.54	1.97	1.27
<i>prej të cilave: Ushqimi</i>	0.46	0.19	0.27	0.89	1.15	2.51	2.53	1.85	1.09
<i>Buka dhe Drithërat</i>	0.06	0.22	0.14	0.13	0.38	1.08	1.28	1.36	0.79
<i>Pemët</i>	0.12	0.18	-0.02	-0.05	-0.19	-0.20	-0.15	-0.05	0.11
<i>Perimet</i>	0.05	-0.10	0.12	0.43	0.46	0.93	0.66	-0.03	-0.20
Pijet alkoolike dhe duhani	0.18	0.09	0.13	0.13	0.16	0.13	0.15	0.15	0.11
<i>prej të cilave: Duhani</i>	0.19	0.10	0.09	0.09	0.08	0.11	0.12	0.09	0.08
Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	-0.01	-0.05	-0.03	-0.01	0.00	0.01	0.11	0.15	0.16
Përdorimi i pajisjeve për transportin personal	0.36	0.04	0.37	0.75	0.83	0.40	0.25	-0.01	-0.14
IÇK (v-m-v, %)	1.47	-0.03	0.72	1.38	2.16	3.20	3.26	2.56	1.67



Grafiku 4 Kontributi i inflacionit të treg. dhe patreg

Grafiku 3 Inflacioni total ndaj inflacionit bazë



Inflacioni bazë¹⁰ në tremujorin e katërt të 2019-ës, i matur duke përjashtuar kategoritë "ushqim dhe pije jo-alkoolike" dhe "transporti", shënoi një rritje vjetore prej 1.1%, që është më e ulët se sa inflacioni total (1.7%), por më e lartë se inflacioni bazë regjistruar në vitin 2018T4 (0.3%). Siç shihet në grafikun 4, komponenti i inflacionit të tregtueshëm¹¹ në 2019T4 vazhdon të përcaktojë sjelljen e inflacionit total dhe vlerësohet të ketë një kontribut rreth 1.63 pikë të përqindjes,

¹⁰ Inflacioni bazë mat ndryshimin e çmimeve të produkteve të shportës së konsumatorit, duke përjashtuar luhatshmërinë e përkohshme dhe tranzitore, e cila kryesisht karakterizon kategorinë e ushqimeve apo të energjisë.

¹¹ Inflacioni i tregtueshëm mat ndryshimin e çmimeve të atyre produkteve që janë të ekspozuara ndaj tregtisë në tregjet ndërkombëtare dhe rrjedhimisht çmimet e tyre nuk ndikohen nga zhvillimet në tregun lokal. Ndërsa, inflacioni i patregtueshëm mat ndryshimin e çmimeve të atyre produkteve që nuk tregtohen në tregjet ndërkombëtare dhe rrjedhimisht ndikohen nga tregu i brendshëm lokal.

ndërkohë që kontributi i komponentit të inflacionit të pa-tregtueshëm vazhdon të ngelet neglizhent.

SEKTORI I JASHTËM

Llogaria Rrjedhëse

Deficiti tregtar i mallrave në tremujorin e katërt të vitit 2019 arriti vlerën prej 853.4 milionë €.


- Importi i mallrave gjatë tremujorit të katërt të vitit 2019 shënoi rritje vjetore prej 6.9%. Kontribut më të theksuar shënuan kategoritë e importeve të makinerive (1.7 p.p.); e artikujve ushqimorë (1.5 p.p.); dhe mjeteve të transportit (1.2 p.p.). Ndërsa kontributi negativ më i lartë prej 1.3 p.p. erdhi nga produktet minerale”.
- Eksporti i mallrave gjatë tremujorit të katërt 2019 shënoi një rënie vjetore prej 7.7%. Kjo rënie ka ardhur kryesisht nga ngadalësimi në eksportet e metaleve bazë dhe produkteve minerale në fund të 2019-ës. Eksportet e makinerive dhe eksportet e vajrave ushqimore kishin kontribut pozitiv me (2.8 p.p.) dhe (1.0 p.p.), respektivisht. Megjithatë, kontributi negativ i metaleve bazë me (10.3 p.p.) dhe i mineraleve me (2.7 p.p.) ishte dukshëm më i lartë.

Suficiti tregtar i shërbimeve për tremujorin e katërt të 2019-ës është 96.4 milionë € dhe është rreth 7.3% më i ulët se bilanci në periudhën e njëjtë të vitit 2018. Kjo reflekton një ngadalësim të dukshëm në eksportin e shërbimeve.

- Eksporti i shërbimeve për tremujorin e katërt të vitit 2019 ishte 0.1% më i lartë se ai në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kryesisht për shkak të një rënie të shërbimeve të transportit të cilat kishin një kontribut negativ prej 0.6 p.p. dhe atyre të ndërtimit me kontribut negativ prej 2.7 p.p.. Në anën tjetër, edhe pse shërbimet e udhëtimit kishin një kontribut pozitiv prej 5.5 p.p., ato shënuan një rritje më të ngadaltë në terma vjetorë.
- Importi i shërbimeve kishte një rritje vjetore prej 5.0%, kryesisht si rezultat i rritjes së importit të transportit dhe udhëtimit të cilat kontribuan me 5.8 p.p. dhe 5.0 p.p., respektivisht. Ndërsa shërbimet kompjuterike kishin një kontribut negativ prej 5.9% gjatë këtij tremujori.

Si rezultat i zhvillimeve në totalin e importeve dhe eksporteve, deficiti tregtar i mallrave dhe shërbimeve në tremujorin e katërt është rreth 2.1% më i lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Grafiku 5 Llogaria rrjedhëse




Bilanci i të ardhurave parësore për tremujorin e katërt 2019 ka shënuar një rënie prej 4.7%, duke arritur një vlerë prej 35.7 milionë euro, kryesisht si rezultat i të ardhurave më të ulëta nga kategoria e kompensimit të punëtorëve. Bilanci i të ardhurave dytësore për këtë tremujor arriti vlerën prej 393 milionë euro, që është 15.3% më i lartë se bilanci në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo rritje i atribuohet kryesisht përmirësimit të bilancit

të transfereve të korporatave financiare, jo-financiare, dhe ekonomive familjare (12.4 %, v-m-v) dhe transfereve zyrtare qeveritare (28.0%, v-m-v).

Si rezultat i zhvillimit të bilancit tregtar të mallrave dhe shërbimeve, bilancit të të ardhurave parësore dhe dytësore, bilanci i llogarisë rrjedhëse për tremujorin e katërt të 2019-ës ishte -253.3 milionë euro, që tregon një deficit më të zgjeruar në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kur bilanci i llogarisë rrjedhëse kishte vlerë prej 235.1 milionë euro.

Llogaria Financiare

Grafiku 6 Llogaria Financiare



○ Bilanci i llogarisë financiare për tremujorin e katërt të 2019-ës është rritur me rreth 28.4 milionë euro. Kjo kryesisht si rrjedhojë e një rënie në hyrjet e investimeve të huaja direkte dhe një rritje në asetet e investimeve portfolio.

○ Gjatë kësaj periudhe, hyrjet totale të IHD-ve kishin një rënie prej 43.8% apo 34.7 milionë euro, krahasuar me periudhën e njëjtë të 2018-ës. Ky zhvillim erdhi kryesisht nga mos ri-investimi i fitimit të ri (kryesisht në sektorin e ndërtimit).

SEKTORI FINANCIAR


- Tremujori i katërt i vitit 2019 paraqet një rritje vjetore më të moderuar të kredive të reja prej 1.5%. Kjo i atribuohet rritjes prej 4.0% në kreditë e korporatave jo-financiare, ndërsa kreditë investuese dhe ato konsumuese shënuan rënie.
- Depozitat e reja në tremujorin e katërt shënuan një rënie vjetore prej 5.9%, duke reflektuar një rënie të depozitave të ekonomive familjare për 5.2% dhe atyre të korporatave jo-financiare prej 6.7%.
- Norma efektive e interesit për kreditë e reja për tremujorin e katërt të vitit 2019 ishte mesatarisht 6.4%, ndërsa ajo për depozitat e reja ishte mesatarisht 1.5%.
- Kreditë jo-performuese gjatë tremujorit të katërt ishin 2.2% të totalit të kredive, duke treguar një përmirësim nga tremujori i katërt i vitit të kaluar (2.7%).

Tabela Indikatorët e Sektorit Financiar

	2017	2018				2019			
	Mes.	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4
Depozitat e reja % Δ	-10.4	20.6	19.0	17.9	36.1	0.8	22.6	-0.1	-5.9
Kreditë e reja % Δ	13.7	14.6	12.3	-3.7	0.7	-5.0	1.8	26.1	1.5
Norma efektive e interesit në kredi të reja	7.3	6.9	6.7	6.7	6.3	6.7	6.4	6.4	6.4
Norma efektive e interesit në depozita të reja	0.9	1.1	1.2	1.5	1.4	1.5	1.4	1.4	1.5
Kreditë jo-performuese	4.7	3.0	2.9	2.8	2.7	2.6	2.6	2.3	2.2

TREGU I PUNËS

Grafiku 7 Indikatorët e tregut të punës



- Anketa e Fuqisë Punëtore për 2019 TM4 tregon se shkalla e papunësisë është 25.9%, e cila është 5.5 pikë përqindje më e ulët se norma e shënuar në tremujorin e katërt të vitit 2018.
- Raporti i punësimit ndaj popullsisë ka arritur nivelin prej 30.7% në tremujorin e katërt të 2019-ës, ndërkohë që në vitin 2018 ka qenë 28.8%.
- Si rezultat i zhvillimeve në ecurinë e punësimit, papunësisë dhe atyre demografike, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, sipas ASK-së në këtë tremujor është 41.4% në një nivel gati se të njëjtë sikur në tremujorin e katërt të 2018-ës (rreth 42.0%).


KLIMA E BIZNESIT

Regjistri i bizneseve, TM4 2019

- Numri i bizneseve të reja gjatë tremujorit të katërt të 2019-ës ishte 2,566, duke qenë 165 biznese më shumë apo 6.9% më i lartë se numri i bizneseve të regjistruara gjatë tremujorit të katërt të vitit 2018.
- Bizneset e reja të regjistruara në kategorinë e prodhimit shënuan rritjen më të lartë, duke u pasuar nga ato të regjistruara në tregti, në aktivitetet profesionale dhe në shërbimet e akomodimit.
- Struktura e ndërmarrjeve të reja të regjistruara gjatë tremujorit të katërt të 2019-ës ishte: 2,539 mikro ndërmarrje (1-9 të punësuar), 25 ndërmarrje të vogla (10-49 të punësuar) dhe 2 ndërmarrje të mesme (50 deri 249 të punësuar).
- Numri i bizneseve të shuara gjatë këtij tremujori arriti në 491. Shuarja e bizneseve ka qenë më e theksuar në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë (rreth 1/3 e tyre).

Anketa e Odës Ekonomike të Kosovës TM4 2019

Grafiku 8 Klima e biznesit



Bazuar në të dhënat nga Oda Ekonomike e Kosovës, për tremujorin e katërt të vitit 2019, treguesi i klimës së biznesit, i cili ofron vlerësime të bizneseve për gjendjen aktuale të ekonomisë, në tremujorin e katërt ka mbetur njëjtë sikurse në tremujorin e katërt të 2018-ës, ndërsa pritjet për gjashtë muajt e ardhshëm janë përmirësuar dukshëm në krahasim me të

njëjtën periudhë të vitit 2018. Gjithashtu, edhe pritjet për punësim janë përmirësuar në krahasim me tremujorin e katërt të 2018-ës.

Në industrinë përpunuese, gjendja aktuale e klimës së biznesit është përmirësuar. Kompanitë ishin më optimiste për pritjet e përgjithshme, mirëpo pritjet e tyre për punësim nuk ishin edhe aq optimiste në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Në tregti (si me pakicë ashtu edhe me shumicë), klima e biznesit ka mbetur kryesisht e njëjtë. Perspektiva për gjashtë muajt e ardhshëm si dhe pritjet për punësim janë mjaft optimiste sidomos te ndërmarrjet e shitjes me shumicë.

Klima e biznesit në sektorin e shërbimeve për tremujorin e katërt u përmirësua lehtësisht. Sektori e vlerësoi situatën e tyre aktuale si më të mirë dhe pret që aktiviteti i tyre të vazhdojë të përmirësohet brenda muajve të ardhshëm.

Në ndërtimtari, indeksi tregon rënie të lehtë. Ndërmarrjet e ndërtimit vlerësuan se situata e tyre nuk do të jetë e kënaqshme në gjashtë muajt e ardhshëm. Mirëpo, pritjet për punësim janë më të larta në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Financat Publike


Të hyrat

- **Të hyrat e përgjithshme** buxhetore arritën në 509.3 milionë euro gjatë tremujorit të katërt, duke shënuar një rritje vjetore prej 9.1% dhe një normë realizimi prej 95.4% të shumës së parashikuar për këtë periudhë.
- **Të hyrat tatimore** për këtë periudhë shënuan vlerën 440 milionë euro ose një rritje vjetore prej 6.9%. Këto të hyra arritën 95.2% të të hyrave të parashikuara për këtë periudhë.
- **Të hyrat direkte** arritën vlerën 72.4 milionë euro dhe janë për 3.6% më të larta se sa periudha e njëjtë e vitit të kaluar. Prej tyre, të hyrat nga Tatimi në të Ardhura të Korporatave arritën në 21.9 milionë euro (apo një rënie vjetore prej 7.2%); Tatimi në të Ardhurat Personale, arriti vlerën prej 42.9 milionë euro (rritje vjetore prej 9.4%); Tatimi në Pronë pati një rritje vjetore prej 1.3%, duke arritur kështu vlerën prej 6.1 milionë euro.
- **Të hyrat indirekte** në këtë tremujor kishin një rritje vjetore prej 7.9%. Këto të hyra ishin kryesisht të nxitura nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (8.2%, v-m-v); pasuar nga të hyrat nga akciza (10.6%,v-m-v); ndërkohë detyrimi doganor është pothuajse në vlerën të njëjtë me tremujorin e vitit të kaluar.
- **Të hyrat jo-tatimore** për këtë periudhë rezultuan 57.8 milionë euro, me një rritje vjetore prej 5.0% dhe një normë realizimi prej 94.6% realizim.


Shpenzimet

- **Shpenzimet buxhetore** në tremujorin e katërt arritën vlerën prej 726.2 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 13.9%, por duke qenë më të ulëta se sa projeksionet (një normë realizimi prej 89.2%).
- **Shpenzimet rrjedhëse** arritën vlerën prej 450.7 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 12.3%.
 - Kategoria e pagave arriti vlerën 158.6 milionë euro (rritje vjetore prej 3.9%);
 - Mallrat dhe shërbimet arritën vlerën 110.5 milionë euro (rritje vjetore prej 20.0%);
 - Transferet dhe Subvencionet arritën vlerën 181.7 milionë euro (rritje vjetore prej 16.1%);
- **Shpenzimet kapitale** arritën vlerën prej 271.4 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 16.6%.
- **Shpenzimet e interesit** arritën vlerën 4.1 milionë euro në 2019TM4, duke qenë 20.3% më të larta se periudha e njëjtë e vitit paraprak.

Grafiku 9 Kontributet në të hyrat buxhetore



Grafiku 10 Kontributet në shpenzime buxhetore



Bilanci i përgjithshëm buxhetor

- **Bilanci i përgjithshëm kumulativ** buxhetor në fund të 2019-ës arriti në -202.7 milionë euro, ndërsa sipas rregullës fiskale, deficitin arriti 19.3 milionë euro apo 0.3% të BPV-së, brenda rregullës fiskale.
- **Bilanci përgjithshëm bankar** në fund të 2019-ës arriti vlerën prej 367.9 milionë euro ose 5.2% e BPV-së (duke respektuar rregullën fiskale prej më së paku 4.5%).

INFORMATA TË TJERA: ANALIZË E LLOGARISË RRJEDHËSE NGA KËNDVËSHTRIMI I HENDEKUT NDËRMJET KURSIMEVE DHE INVESTIMEVE

Llogaria rrjedhëse është një prej treguesve kryesorë që përdoret në diagnostifikimin e qëndrueshmërisë së një ekonomie. Nëse një vend karakterizohet në mënyrë të vazhdueshme nga deficite të mëdha të llogarisë rrjedhëse, nuk do të thotë domosdoshmërisht që qëndrueshmëria afatgjatë e ekonomisë së këtij vendi është çënuar për sa kohë nuk është çënuar aftësia paguese e këtij vendi. Një vend konsiderohet të ketë aftësi paguese, nëse vlera aktuale e suficiteve të ardhshme tregtare barazon borxhin e saj aktual, çka do të thotë se i përmbush kufizimet e jashtme buxhetore gjatë periudhave të ndryshme kohore.

Një mënyrë për një gjykim më të shpejtë mbi qëndrueshmërinë e llogarisë rrjedhëse të një vendi është analizimi i përbërjes së saj. Përgjithësisht, literatura argumenton se një deficit i llogarisë rrjedhëse që shkaktohet kryesisht nga deficit i lartë tregtar është më pak i qëndrueshëm se sa një llogari rrjedhëse që shkaktohet nga pozicione të mëdha negative të të ardhurave faktoriale, pasi në rastin e parë do të nënkuptohej ekzistenca e problemeve strukturore të konkurrueshmërisë. Një mënyrë e dytë është analizimi i llogarisë rrjedhëse nga pikëpamja e llogarive kombëtare, sipas së cilës llogaria rrjedhëse përfaqëson hendekun ndërmjet kursimeve nacionale (private dhe publike) dhe investimeve totale (private dhe publike). Studime të ndryshme konvergjojnë në gjetjen se rënia e kursimeve private e bën llogarinë rrjedhëse më pak të qëndrueshme se sa rritja e investimeve.


Qëllimi i kësaj analizë të shkurtër (më poshtë) nuk është të vlerësojë qëndrueshmërisë e llogarisë rrjedhëse në rastin e Kosovës, por të analizojë ecurinë e saj nga këndvështrimi i kursim investimeve gjatë periudhës 2013T1: 2019T3¹², duke identifikuar nëse ka qenë hendeku i kursim- investimeve private apo ai publik që ka kontribuar më së shumti në deficitin e llogarisë rrjedhëse. Gjithashtu, analiza ofron një krahasim të shpejtë më vendet e Ballkanit Perëndimor për sa i përket ecurisë së llogarisë rrjedhëse, kursimeve, dhe investimeve- të shprehura si përqindje ndaj BPV-së.

Një vështrim i shpejtë rajonal mbi ecurinë e llogarisë rrjedhëse në vendet e Ballkanit Perëndimor tregon se Kosova, mesatarisht gjatë periudhës 2013- 2018 është karakterizuar nga një deficit i llogarisë rrjedhëse prej 6.6% të BPV-së. Ky nivel është më i lartë se deficitin e regjistruar nga Maqedonia e Veriut, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia, por më i ulët se Shqipëria dhe Mali i Zi (grafiku 1a). Megjithatë, nëse krahasojmë përbërjen e llogarisë rrjedhëse sipas hendekut kursim-investime, vihet re se Kosova ka nivelin e dytë më të lartë të kursimeve si përqindje ndaj BPV-së dhe nivelin e tretë më të lartë të investimeve si përqindje ndaj BPV-së. Maqedonia e Veriut ka nivelin më të lartë të kursimeve kombëtare (si % ndaj BPV-së), mirëpo ky nivel kompensohet pothuajse plotësisht nga një nivel i ngjashëm i investimeve kombëtare (grafiku 1b). Hendeku më i madh vihet re në Malin e Zi, i cili karakterizohet nga një nivel shumë i ulët i kursimeve private (më i ulët ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor) dhe një nivel i lartë i investimeve kombëtare (i dyti më i larti). Në rastin e Kosovës, gjatë tremujorit të tretë të 2019-ës, llogaria rrjedhëse shënoi suficit rreth 7.6% të BPV-së, ndërkohë që në dy tremujorët e parë të vitit 2019 ky hendek ka qenë negativ. Në tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, llogaria rrjedhëse ka qenë në suficit por në një

¹² Kjo analizë është realizuar për periudhën 2013TM1: 2019TM3 për shkak të disponueshmërisë së të dhënave për Bruto Produktin Vendor.

nivel më të ulët, rreth 4.0% e BPV-së. Ky suficit në 2019TM3 i atribuohet hendekut pozitiv ndërmjet kursimeve dhe investimeve në sektorin privat dhe në sektorin publik, veçanërisht në të parin.

Grafiku 51. Hendeku Kursi- Investime: Ballkani Perëndimor



Hendeku i kursimeve private në 2019TM3 u vlerësua në 7.2% të BPV-së, çka nënkupton kursime më të larta se investime në sektorin privat. Ky raport është 2.0 pikë përqindje më i lartë krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë. Raporti i investimeve private ndaj BPV-së në 2019TM3 ka qëndruar pothuajse i pandryshuar krahasuar me një vit më parë, rreth 23%, ndërkohë raporti i kursimeve private ndaj BPV-së është rritur në 30.2% nga 28.2%. Në tërësi, zgjerimi i hendekut pozitiv në sektorin privat gjatë 2019TM3 ka qenë i dominuar plotësisht nga dinamika e kursimeve private.

Në sektorin publik, në 2019TM3 hendeku shënoi tepriçë pozitive (0.4% e BPV-së), ndërkohë që një vit më parë ky hendek ishte negativ (rreth -1.2% e BPV-së). Investimi publik si përqindje ndaj BPV-së ka qëndruar i pandryshuar krahasuar me një vit më parë (rreth 6.0%), ndërkohë që kursimet publike si përqindje e BPV-së janë rritur nga 4.9% në 2018TM3 në 6.5% në 2019TM3. Në këtë mënyrë, rritja e kursimeve publike ka ndikuar në kthimin e hendekut nga negativ në pozitiv gjatë tremujorit të tretë të 2019-ës.

Në nivel kombëtar (publik dhe privat), raporti i investimeve ka qëndruar pothuajse i pandryshuar (rreth 29%), ndërsa raporti i kursimeve është rritur me rreth 3.5 pikë përqindje krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Zgjerimi i kursimeve në nivel kombëtar ka qenë përcaktuesi kryesor në zgjerimin e tepriçës së llogarisë rrjedhëse në terma vjetorë.

Grafiku 12. Kontributi i treguesve të investimeve dhe kursimeve në dinamikën e llogarisë

